

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"IR PETROL" SH.P.K.**

Sot, në datën 04.09.2025, *Znj. Irba Ruçi* shtetase shqiptare, lindur me 25.04.2002, ne Berat dhe banuese ne Tirane madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e dokumentit te identifikimit Nr. K25425001G, në cilësinë e Ortakëut Themelues, vendosën të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar **"IR PETROL" Shpk**. Kjo shoqëri do të realizojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 1 – EMËRTIMI

Shoqëria emërtohet **"IR PETROL" Shpk**.

NENI 2 – FORMA

Shoqëria **"IR PETROL" Shpk** themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 3 – SELIA

Selia e Shoqërisë është në adresën Lushnje, Krutje e Poshtme, Nr. Pasurie 100/30, Zona kadastrale Nr. 2286.

Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci në adresa të tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresa sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.

NENI 4 – OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston në kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara më poshtë: - Tregtimi me pakice i karburanteve, gazit të lengshëm dhe vajra lubrifikante.

Bar kafe, fast food.

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat ligjore në fuqi. Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj në baze të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

NENI 5 – KOHËZGJATJA

Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.

Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 6 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT

Kapitali i shoqërisë është 100 000 Lekë (njqind mije). Kapitali i shoqërisë ndahet në 1 (nje) kuote të zotëruar nga ortakët i vetëm si në vijim:

Znj. Irba Ruçi, zoteron 1 kuote, të barabartë me 100% të pjesëmarrjes në kapitalin të shoqërisë;

NENI 7 –TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8 – ADMINISTRATORI/ËT

Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojnë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.


Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe çdo rast në zbatim të kufijve të përcaktuar në aktin e emërimit të tij dhe/ose në Statutin e Shoqërisë.

Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë të posaçme (“ad negotia”) për kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.

Caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:

Znj. Irba Ruçi shtetase shqiptare, lindur me 25.04.2002, ne Berat dhe banuese ne Tirane madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e dokumentit te identifikimit Nr. K25425001G, per nje periudhe 5 vjecare..

Specimeni i Firmës së Administratorit të Parë të Shoqërisë është si më poshtë:

Emër Mbiemër	Nënshkrimi
Irba Ruçi	

NENI 9 – GJUHA

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT

Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt - Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislationit shqiptar.

* *

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“IR PETROL” shpk

Irba Ruçi

